



**Agjencia Kombëtare e Arsimit, formimit profesional dhe Kualifikimeve
Sektori i Profesioneve dhe i Kualifikimeve Profesionale**

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“MEKANIË BUJQËSORE”

Niveli III në KSHK¹, referuar nivelit III të KEK²

M6-III-16

Tiranë më, Shtator 2016

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza Evropiane e Kualifikimeve

Emërtimi i kualifikimit	“Mekanikë bujqësore”			Kodi
Kohëzgjatja	900-1100 orë	Niveli	III në KSHK, referuar nivelit III të KEK	M6-III-16
Qëllimi	Qëllimi i kualifikimit profesional të profilit “Mekanikë bujqësore” niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK,” është të përgatisë punonjës të kualifikuar për riparimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve mekanike të makinave bujqësore, si dhe të zhvillojë personalitetin e nxënësve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon dhe përgatitja e tyre për t’u punësuar në veprimtaritë profesionale që lidhen drejtpërdrejt me profilin “Mekanikë bujqësore” .			
Kriteret e përgjithshme të pranimit	Në institucionet e arsimit profesional që ofrojnë kualifikim profesional në profilin “Mekanikë bujqësore” të nivelit të tretë në KSHK, referuar nivelit III të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: <ul style="list-style-type: none"> - kanë mbaruar dy vitet e para të shkollës së mesme profesionale në drejtimin “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK ; - janë në kushte shëndetësore që përballojnë kërkesat e këtij niveli të arsimit profesional; 			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Mekanikë bujqësore” niveli III i KSHK, referuar nivelit III të KEK, e pajis individin me Certifikatën profesionale dhe Supplementin përkatës të punonjësit të kualifikuar në këtë fushë. Ky arsimim i jep mundësi individit t’i drejtohet tregut të punës për punësim në subjekte të “Mekanikës bujqësore”, për makina bujqësore, si dhe në veprimtari të tjera ku ushtrohen veprimtari për shërbime mekanike. Gjithashtu, individit mund të vetëpunësohet në kuadrin e një biznesi individual në fushën e mirëmbajtjes dhe riparimit të pjesëve të mekanikës bujqësore. Në përfundim të kualifikimit profesionale “Mekanikë bujqësore”, niveli III në KSHK, referuar nivelit III të KEK, individit ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin IV të KSHK, referuar nivelit IV të KEK, të kualifikimit profesional (njëvjeçar) të drejtimit “Shërbime mjetesh transporti” dhe fiton të drejtën e Diplomës së “Maturën Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe universitare.			
Data e validimit				
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	Nuk ka			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT:

Rezultatet e të nxënit në:

NJOHURI PROFESIONALE

Planifikimi, organizimi dhe përgatitja e vendit të punës për punimet e mekanikës bujqësore

- Të shpjegojë rolin dhe rëndësinë e sipërmarrjes së biznesit;
- Të përshkruajë veçoritë e tregut dhe veprimtaritë që kryhen në të;
- Të shpjegojë kuptimin, rëndësinë, mjetet dhe strategjitë e marketingut;
- Të shpjegojë rëndësinë e legjislacionit të punës dhe elementët përbërës të tij;
- Të shpjegojë rëndësinë, nevojën dhe aspektet kryesore të përdorimit të Teknologjisë së Informimit dhe Komunikimit (TIK) për krijimin e kontakteve në biznes;
- Të përshkruajë shërbimet e mekanikës bujqësore dhe të argumentojë rëndësinë e kryerjes së tyre;
- Të klasifikojë llojet e shërbimeve të mekanikës bujqësore;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e një servisi për shërbimet e mekanikës bujqësore;
- Të dallojë veglat, instrumentet dhe pajisjet e punës në një servis për shërbimet e mekanikës bujqësore dhe përdorimet e tyre;
- Të përshkruajë organizimin dhe postet e punës në një servis për shërbimet e mekanikës bujqësore;
- Të përshkruajë veprimet për sigurimin e bazës materialo-teknike për shërbimet e mekanikës bujqësore;
- Të përshkruajë procesin e kontrollit paraprak të traktorit apo makinave bujqësore për pranimin e tyre;
- Të përshkruajë procesin e vendosjes së traktorit apo makinave bujqësore në vendin e kontrollit për shërbime të ndryshme;
- Të përshkruajë masat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e mekanikës bujqësore;
- Të plotësojë dokumentacionin teknik për shërbimet e mekanikës bujqësore;

Njohuri në lidhje me proceset e punës për mekanikën bujqësore

- Të shpjegojë ndërtimin dhe organizimin e një servisi për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave bujqësore;
- Të përshkruajë procedurat e pranimit në servis të makinave bujqësore;
- Të tregojë radhën e diagnostikimit të makinave bujqësore;

- Të shpjegojë punimet që bëhen në servis për vajtjen dhe gratimin e makinave bujqësore;
- Të përshkruajë riparimet e çastit në makinat bujqësore;
- Të përshkruajë riparimet periodike në makinat bujqësore;
- Të përshkruajë dokumentacionin teknik që përdoret në serviset e makinave bujqësore;
- Të përshkruajë dokumentacionin administrativ që përdoret në serviset e makinave bujqësore;
- Të përshkruajë dokumentacionin financiar që përdoret në serviset e makinave bujqësore;
- Të përshkruajë masat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në servisin për mirëmbajtjen dhe riparimin e makinave bujqësore;

Njohuri të planifikimit, organizimit dhe përgatitjes së punimeve të mekanikës bujqësore

- Të përshkruajë rregullat e organizimit të punës për sigurimin e cilësisë dhe parandalimin e aksidenteve për punimet e mekanikës bujqësore;
- Të përshkruajë veglat, pajisjet e materialet e punës për kryerjen e punimeve të mekanikës bujqësore si dhe përzgjedhjen, përdorimin, kujdesin e mirëmbajtjen e tyre;
- Të përshkruajë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të përshkruajë dokumentacionin teknik e financiar të nevojshëm për pranimin dhe kryerjen e punimeve në teknikën bujqësore (makina bujqësore, makina blegtorale, traktorë, autokombajna etj.);
- Të listojë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura, sipas proceseve të punës për shërbimet e mekanikës bujqësore;

Ndërtimi dhe funksionimi i mekanizmit të transmetimit të fuqisë në traktorët bujqësor.

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit të transmetimit të fuqisë së traktorit me rrota dhe me zinxhirë;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmin e transmetimit të fuqisë së traktorit me rrota dhe me zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pjesëve lëvizëse të traktorit me zinxhirë (rama, varëset, elementët e zinxhirit);
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët lëvizëse të traktorit me zinxhirë (rama, varëset, elementët e zinxhirit);
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pjesëve lëvizëse të traktorit me rrota (rama, akset, varëset dhe rrotat);
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pjesët lëvizëse të traktorit me rrota (zinxhirë) (rama, akset, varëset dhe rrotat);

- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ecjes së traktorit me rrota dhe me zinxhirë;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e ecjes së traktorit me rrota dhe me zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të drejtimit të traktorit me rrota;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e drejtimit të traktorit me rrota;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të frenimit të traktorit me zinxhirë;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e frenimit të traktorit me zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të frenimit të traktorit me rrota;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e frenimit të traktorit me rrota;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve ndihmëse të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në pajisjet ndihmëse të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e sistemit të ndriçimit të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të përshkruajë punimet e mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e ndriçimit të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kabinës të traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në kabinën e traktorit me rrota dhe zinxhirë;
- Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e pajisjeve të punës në traktorët me rrota dhe zinxhirë (hallka e rimorkimit, sistemi varës-hidraulik, boshti i marrjes së fuqisë, pajisjet që përmirësojnë aftësinë e kapjes së rrotave aktive me rrugën etj.) ;
- Të përshkruajë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit të pajisjeve të punës që përdoren në traktorët me rrota dhe zinxhirë (hallka e rimorkimit, sistemi varës-hidraulik, boshti i marrjes së fuqisë, pajisjet që përmirësojnë aftësinë e kapjes së rrotave aktive me rrugën etj.) ;

Hidraulika në mekanikën bujqësore:

- Të përshkruajë elementët dhe funksionin e një skeme të thjeshtë në transmesionet hidraulike të fuqisë;
- Të përshkruajë principin e punës së pompave që përdoren në sistemet hidraulike, si pompave centrifugale, me ingranazhe, me fletë, me piston, etj.;

- Të përshkruajë funksionin e cilindrave hidraulike, shpërndarësive, valvolave të sigurisë, valvolat e rregullimit të prurjes ose presionit, akumulatorët, droselat, filtrat, serbatorët, etj.;
- Të përshkruajë llojet e hermetizuesve dhe karakteristikat e tyre;

NDËRTIMI DHE FUNKSIONIMI I MAKINAVE KRYESORE QË PËRDOREN NË TEKNIKËN BUJQËSORE

Makinat e punimit të tokës

- Të listojë parregullsitë në makinat e punimit të tokës;
- Të listojë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave të punimit të tokës;
- Të përshkruajë procedurat e gratimeve të pjesëve të plugjeve të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së plugjeve të ndryshëm për regjime të ndryshme punimi;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të disqeve të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së disqeve të ndryshëm për regjime të ndryshme punimi;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të frezave të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së frezave të ndryshëm për regjime të ndryshme punimi;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të lesave të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së lesave të ndryshme për regjime të ndryshme punimi;

Makinat mbjellëse

- Të listojë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave mbjellëse;
- Të listojë parregullsitë paraprake në makinat mbjellëse;
- Të përshkruajë procedurat e gratimit të pjesëve të makinave mbjellëse të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve në makinat mbjellëse me rreshta, në makinave mbjellëse të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes në makinat mbjellëse me rreshta, në makinat mbjellëse të llojeve të ndryshme;
- Të përshkruajë mënyrën e përdorimit të dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave mbjellëse që do të zëvendësohen;

Makinat e shërbimit të bimëve

- Të listojë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave të shërbimit të bimëve;
- Të përshkruajë informacionin paraprak për parregullsitë në makinat e shërbimit të bimëve;
- Të përshkruajë procedurat e gratimit të pjesëve të makinave të shërbimit të bimëve të ndryshme;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të kultivatorëve, makinave spërkatëse, ujitëse, plehëruese etj.;

- Të përshkruajë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes së kultivatorëve, makinave spërkatëse, ujitëse, plehëruese etj., për regjime të ndryshme pune;
- Të shpjegojë provat e funksionimit të makinave të shërbimit që mirëmbahen ose riparohen;
- Të shpjegojë përdorimin e dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave të shërbimit të bimëve që do të zëvendësohen;

Makinat e mbledhjes së prodhimit bujqësor

- Të përshkruajë informacionin paraprak për parregullsitë në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të listojë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të përshkruajë procedurat e grasatimit të pjesëve në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të pjesëve në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të përshkruajë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të shpjegojë provat e funksionimit të makinave të mbledhjes së prodhimit që mirëmbahen ose riparohen;
- Të shpjegojë përdorimin e dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave të mbledhjes së prodhimit që do të zëvendësohen;

Rimorkiot e transportit bujqësor

- Të përshkruajë informacionin paraprak për parregullsitë në rimorkiot e transportit;
- Të listojë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive në rimorkiot e transportit;
- Të përshkruajë procedurat e grasatimeve të ndryshme në rimorkiot e transportit;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të elementëve në mekanizmat e tërheqjes e varjes, mekanizmat e kthimit të rrotave, në sistemin e frenave, në mekanizmin ngritës hidraulik, në sistemin elektrik, në karroceri të llojeve të ndryshme në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të rrotave në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të kushinetave në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të shpjegojë provat e funksionimit të rimorkiove të transportit bujqësor që mirëmbahen ose riparohen;
- Të shpjegojë përdorimin e dokumentacionit teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e rimorkiove të transportit bujqësor që do të zëvendësohen;
- Të përshkruajë të dhënat e nevojshme dhe dokumentacionin përkatës në planet e montimit, diagnostikimin e defektit, çmontimin e pajisjeve, riparimin në funksion të parametrave dhe materialeve të disponueshme, zbatimin e rregullit Cilësi-Siguri-Ndërhyrje;

SHPREHI PROFESIONALE

Planifikimi, organizimi dhe përgatitja e punimeve të mekanikës bujqësore

- Të organizojë vendin e punës për punimet e mekanikës bujqësore;
- Të përzgjedhë, përdorë e mirëmbajë veglat, pajisjet e materialet e punës për kryerjen e punimeve të mekanikës bujqësore;

- Të zbatojë standardet e profesionit të mekanikut bujqësor;
- Të zbatojë rregullat e sigurisë në punë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Të lexojë dokumentacionin teknik e financiar të nevojshëm për pranimin dhe kryerjen e punimeve në teknikën bujqësore (makina bujqësore, makina blegtorale, traktorë, autokombajna etj.);
- Të përzgjedhë veglat, pajisjet dhe materialet e duhura, sipas proceseve të punës për shërbimet e mekanikës bujqësore;
- Të bëjë skica të detaleve të thjeshta e të vështirësisë mesatare;
- Të nxjerrë nga një vizatim njeje të thjeshtë dhe të bëjë skicën përkatëse për prodhimin e një ose me shumë detaleve të shoqëruara me tolerancat përkatëse;
- Të përcaktojë pjesët e konsumueshme, të regjistrueshme, elemente fiks dhe të lëvizshëm;
- Të gjejë defektin dhe të përcaktojë origjinën e tij;
- Të shfrytëzojë të dhënat nga vrojtimi i mos funksionimit të pajisjes;
- Të përcaktojë dhe të kryejë tipin e ndërhyrjes së duhur;
- Të sigurojë bashkëpunimin e duhur për rivënien në punë të pajisjes;
- Të respektojë planet e mirëmbajtjes të paracaktuara;
- Të sinjalizojë anomalitë e konstatuara;

Punime në teknikën bujqësore

- Të çmontojë nga makinat e traktorët njësitë e montimit (grupet, nyjet);
- Të zbërthejë njësitë e montimit në detale;
- Të pastrojë pjesët e njërive të montimit;
- Të seleksionojë detalet;
- Të kryejë matje dhe kontrole të nevojshme për shërbime teknike (matje të presionit të ajrit në goma, të presionit të vajit në sistemet hidraulike, matje në sistemet e drejtimit, të konsumit të frenave dhe disqeve të friksionit, etj.) me pajisjet përkatëse;
- Të kryejë punime axhusterie në pjesët e makinave dhe traktorëve;
- Të kryejë punime grasatimi në makinat bujqësore dhe traktorë;
- Të kryejë punime saldimit në pjesët e dëmtuara të makinave bujqësore e traktorëve;
- Të montojë pjesët e njërive të montimit;
- Të montojë njësitë e montimit në makina bujqësore dhe traktorë;
- Të kryejë punime të riparimeve të çastit në detalet dhe njësitë e montimit;
- Të kryejë regjistrimet e duhura në makina bujqësore e traktorë;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të funksionimit të makinave dhe traktorëve bujqësorë;
- Të përpilojë listën e materialeve të nevojshme për punimet në makinat bujqësore e traktorët;
- Të përcaktojë kohën e nevojshme të punës;
- Të përcaktojë vlerën paraprake të punimeve që do të kryhen;

Mirëmbajtja dhe riparimi i traktorëve me rrota

- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e ecjes së traktorit me rrota;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në mekanizmin e transmisionit të traktorit me rrota;

- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e drejtimit të traktorit me rrota;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin e frenimit të traktorit me rrota;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në pajisjet ndihmëse të traktorit me rrota si: boshti i daljes së fuqisë, sistemin hidraulik, mekanizmi i vajosjes;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në sistemin elektrik të traktorit me rrota;
- Të kryejë punime të mirëmbajtjes dhe riparimit në kabinën e traktorit me rrota;

MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I MAKINAVE BUJQËSORE

Makinat e punimit të tokës

- Të marrë informacion paraprak për parregullsitë në makinat e punimit të tokës;
- Të kryejë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave të punimit të tokës;
- Të kryejë procedurat e grastimeve të pjesëve të plugjeve të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së plugjeve të ndryshëm për regjime të ndryshme punimi;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të disqeve të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së disqeve të ndryshëm për regjime të ndryshme punimi;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të frezave të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së frezave të ndryshme për regjime të ndryshme punimi;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të lesave të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e regjistrimeve dhe përshtatjes së lesave të ndryshme për regjime të ndryshme punimi;

Makinat mbjellëse

- Të marrë informacion paraprak për parregullsitë në makinat mbjellëse;
- Të kryejë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave mbjellëse;
- Të kryejë procedurat e grastimit të pjesëve të makinave mbjellëse të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve në makinat mbjellëse me rreshta e me, saktësi, makinave mbjellëse të patates e të fidanëve të llojeve të ndryshme;
- Të kryejë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes në makinat mbjellëse me rreshta e me, saktësi, makinave mbjellëse të patates e të fidanëve të llojeve të ndryshme;
- Të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave mbjellëse që do të zëvendësohen;

Makinat e shërbimit të bimëve

- Të marrë informacion paraprak për parregullsitë në makinat e shërbimit të bimëve;
- Të kryejë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive të makinave të shërbimit të bimëve;
- Të kryejë procedurat e grastimit të pjesëve të makinave të shërbimit të bimëve të ndryshme;

- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve të kultivatorëve, makinave spërkatëse, ujitëse, plehëruese etj.;
- Të kryejë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes së kultivatorëve, makinave spërkatëse, ujitëse, plehëruese etj., për regjime të ndryshme pune;
- Të kryejë provat e funksionimit të makinave të shërbimit që mirëmbahen ose riparohen;
- Të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave të shërbimit të bimëve që do të zëvendësohen;

Makinat e mbledhjes së prodhimit bujqësor

- Të marrë informacion paraprak për parregullsitë në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të kryejë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të kryejë procedurat e grasatimit të pjesëve në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të pjesëve në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të kryejë procedurat e regjistrimit dhe përshtatjes në makinat e mbledhjes së prodhimit;
- Të kryejë provat e funksionimit të makinave të mbledhjes së prodhimit që mirëmbahen ose riparohen;
- Të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e makinave të mbledhjes së prodhimit që do të zëvendësohen;

Rimorkiot e transportit bujqësor

- Të marrë informacion paraprak për parregullsitë në rimorkiot e transportit;
- Të kryejë kontrollet e duhura për përcaktimin e parregullsive në rimorkiot e transportit;
- Të kryejë procedurat e grasatimeve të ndryshme në rimorkiot e transportit;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të elementëve në mekanizmat e tërheqjes e varjes, mekanizmat e kthimit të rrotave, në sistemin e frenave, në mekanizmin ngritës hidraulik, në sistemin elektrik, në karroceri të llojeve të ndryshme në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të rrotave në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të kryejë procedurat e zëvendësimit të kushinetave në rimorkiot e transportit bujqësor;
- Të kryejë provat e funksionimit të rimorkiove të transportit bujqësor që mirëmbahen ose riparohen;
- Të përdorë dokumentacionin teknik (katalogët) për të përzgjedhur pjesët e rimorkiove të transportit bujqësor që do të zëvendësohen;

Proceset përfundimtare në punimet e mekanikës bujqësore

- Të bëjë kontrollin përfundimtar të punimeve të kryera;
- Të bëjë kontrollin përfundimtar të mjetit dhe makinave bujqësore;
- Të japë garanci për punimet e kryera;
- Të përpilojë dokumentacionin teknik për punimet e kryera;
- Të përpilojë listën e materialeve të përdorura;
- Të përpilojë preventivin për punimet e kryera;

- Të përcaktojë kohën e punës për punimet e kryera;
- Të përcaktojë vlerën (çmimin) e punimeve të kryera;
- Të përpilojë faturën për klientin;

Rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit

- Të sigurojë veshjen e përshtatshme për punë;
- Të mbajë pastër vendin e punës;
- Të hedhë mbetjet dhe papastërtitë në vendet e përcaktuara;
- Të sigurojë hapësira të lira për raste rreziku;
- Të sigurojë gatishmërinë e mjeteve zjarrfikëse;
- Të përdorë mjetet Mbrojtjes Kundër Zjarrit;
- Të sigurojë vendosjen e mjetit mbi urën ngritëse, krik dhe tako;
- Të kontrollojë gjendjen teknike të veglave e pajisjeve të punës;
- Të sigurojë ndriçimin e duhur në mjediset e punës;
- Të sigurojë ajrimin e duhur të mjedisit të punës;
- Të sigurojë mjetet e ndihmës së shpejtë;
- Të japë ndihmën e shpejtë;
- Të kontrollojë tokëzimin e pajisjeve elektrike;
- Të marrë masa që të mos punojë vetëm;

Diagnostikimi

- Të lokalizojë elementë të defektuar;
- Të përcaktojë në bashkëbisedim me përdoruesin për mënyrën se si ka rrjedhur defekti;
- Të kryejë një analizë funksionale të pajisjes duke u nisur nga skema përkatëse ose nga vetë pajisja në dispozicion;
- Të identifikojë elementët fiks ose të lëvizshëm, të rregullimit, të transmetimit ose të transformimit të lëvizjes;
- Të bëjë verifikimin për prezencë të trupave të huaj në pajisje (ashkla, copa të thyera etj.), që mund të dëmtojnë funksionimin;
- Të përcaktojë me anë të arsytimit ose duke ndjekur zinxhirin e shkaqeve, elementët e dyshimtë ose defekteze (përdorimi i metodës së eliminimit për përcaktimin e elementit);
- Të bëjë diagnostikimin e defekteve me pajisjet elektronike përkatëse;

Çmontimi

- Të përcaktojë logjikën e çmontimit të makinerisë apo pajisjes;
- Të përgatisë vendin e punës dhe përzgjedhë veglat dhe materialet e nevojshme për operacionin e çmontimit;
- Të përcaktojë radhën e punës së çmontimit dhe montimit, mbi bazën e planeve të dosjes teknike dhe vizatimit;
- Të përcaktojë masat mekanike, elektrike dhe të sinjalizimit;

- Të përgatisë vendin e punës, sigurimi i mjeteve të nevojshme për çmontim/montim, mjetet eventuale të shuarjes së zjarrit;
- Të sigurojë autorizimet e nevojshme, lejet për ndërprerjen e ushqimit me energji, lejet e ndërprerjes së punës, lejet për punime me zjarr;
- Të përcaktojë tipat specifike të ndërhyrjes;
- Të respektojë procedurat e çmontimit;
- Të përzgjedhë dhe të përdorë veglat e punës manuale, mekanike dhe elektromekanike, dhe të zbatojë mënyrën e përdorimit të rregullt të tyre sipas karakteristikave specifike;
- Të përgatisë ose të përshtatë një vegël të thjeshtë për një përdorim të veçantë në një pajisje;
- Të konsultojë dosjen e makinës dhe të sigurojë veglat specifike që mund të jenë dhënë në të;
- Të përzgjedhë dhe të përdorë llojet e ndryshme të mjeteve ngritëse dhe mbajtëse manuale (leva, kapëse, ganxha, parango);
- Të zgjedhë në funksion të ngarkesës, peshës, temperaturës, kavot dhe litarët mbajtës;
- Të zbatojë rregullat e përgjithshme në funksion të ngritjes dhe të balancimit të ngarkesave;
- Të zbatojë rregullat e transportimit mbi rrula të ngarkesave;
- Të përcaktojë karakteristikat dhe mënyrat e përdorimit të elementeve të pastrimit;
- Të përcaktojë mënyrën e përdorimit të aparateve të çmontimit me presion të lartë në të nxehtë dhe në të ftohtë, si dhe rastet e përdorimit;
- Të përdorë aparaturat e pastrimit me presion të lartë;
- Të përzgjedhë dhe të përdorë llojet e ndryshme të aparaturave të matjes dhe të kontrollit;
- Të verifikojë dhe të analizojë gjendjen e sipërfaqeve (konsumimi, gripimi, gërryerja, nxehja);
- Të përzgjedhë dhe të përdorë llojet e ndryshme të aparateve matëse dhe të kontrollit të madhësive (elektrike, mekanike, dimensionale dhe gjendjes sipërfaqësore);
- Të zgjedhë aparatet e matjes së rezistencës elektrike, të izolacionit dhe të tokëzimit dhe të bëhen matje me to;

Riparimi në funksion të parametrave dhe të materialit disponues.

Montimi

- Të respektojë radhën kronologjike të operacioneve të montimit të elementeve;
- Të përcaktojë radhën e punës së montimit (pajisje, nyje, detal), mbi bazën e planeve dhe dosjeve teknike;
- Të përdorë veglat dhe pajisjet e nevojshme të mirëmbajtjes dhe të kontrollit;
- Të kryejë montimin dhe rregullimin e pajisjeve të tilla si: reduktor, grup moto-pompë, moto-reduktor, kuti shpejtësie, pulexho dhe rripa të të gjitha llojeve, rrota me dhëmbë (të drejta, helikoidale, konike, shevronë) kremaliere rrotë dhe vidë pa fund, biellë-manivelë, ekscentrikë, gunga, friksion/frenë me disk dhe tambur, xhunto, kryqe;
- Të montojë/çmontojë, pajisje ndihmëse hidraulike me presion të ulët;
- Të montojë dhe të kryejë xhunte, vendosje të premistopeve për lëngje dhe gaze;
- Të montojë/çmontojë, rregullojë pompat centrifugale të tipave të ndryshëm;
- Të montojë elementet hermetizues fiks si: (letër e fortë, amiant kauçuk etj.), rrëshqitëse (me buzë rrethore, metalike) apo rrotulluese (xhunto me buzë, gominë);

- Të bëjë montimin sipas procedurave të përcaktuara dhe sipas përdorimit të lidhjeve fiksuese, të vidave, fermave, kiavetave, frenave, unazave elastike;
- Të kryejë kontrollin e gjendjes funksionale;
- Të zbatojë rregullat e rreshtimit, funksionimit, ekuilibrit statik dhe dinamik të fiksimit të elementeve;
- Të zbatojë metodat e rregullimit të paralelitetit, perpendikularitetit, qendërimit;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta gjeometrike me makinë llogaritëse;
- Të kryejë kontrollin e cilësisë (konformiteti mekanik) dimensionale të elementeve që do të montohen;
- Të verifikojë gjendjen cilësore të elementeve përbërës, të dhënat dimensionale dhe të tolerancës, gjendjen e sipërfaqeve (vlerësim vizual), konformitetin gjeometrik, bazuar në planet dhe dosjen teknike apo udhëzimet përkatëse;
- Të kryejë llogaritje të thjeshta të dimensioneve gjeometrike të elementeve;
- Të kryejë rregullimet (retushimet) funksionale të montimit të elementeve (limë, rasketë, alezues);
- Të zgjedhë dhe përdorë veglat e punës, mjetet ndihmëse normale dhe të veçanta për mirëmbajtjen;
- Të kryejë lubrifikimin e pajisjeve duke përdorur lubrifikantet përkatës;

Punime hidraulike në mekanikën bujqësore

Të çmontojë nyje të pompave të ndryshme hidraulike, cilindra të fuqisë, valvova, shpërndarësa, filtra, etj.

- Të kontrollojë nyje të pompave të ndryshme hidraulike, cilindra të fuqisë, valvola, shpërndarësa, filtra si dhe të kryejë pastrimin sistematik të tyre.;
- Të konstatojë defekte ose konsumime të pjesëve dhe të marrë vendime për zëvendësimin ose riparimin e tyre;
- Të kryejë riparimin e pjesëve të defektuara në sistemin hidraulik të makinerive bujqësore;
- Të kryejë zëvendësimin e pjesëve të defektuara në sistemin hidraulik të makinerive bujqësore;
- Të kryejë punime hermetizimi në sistemin hidraulik të makinave bujqësore;
- Të montojë nyje të pompave të ndryshme hidraulike, cilindra të fuqisë, valvola, shpërndarësa, filtra, etj.;
- Të kryejë prova dhe matje kontrolli me pajisjet përkatëse për të siguruar funksionimin normal të sistemit hidraulik;

Cilësia – Siguria – Ndërhyrja

- Të zbatojë rregullat e sigurisë së shëndetit në punë;
- Të zbatojë rregullat e sigurimit teknik dhe të higjienës vetjake (veshja, syzet, këpucët, dorezat mbrojtëse kundër rrezatimit UV) dhe kolektive (vendosja e ekraneve mbrojtës, tabela sinjalizimi, të mjedisit, të menaxhimit të rasteve të paparashikuara;
- Të zbatojë rregullat respektive gjatë përdorimit të makinave bujqësore e pajisjeve (hidraulike, pneumatike, elektrike), pajisjeve ngritëse dhe transportuese, elementeve me forma të komplikuar, tranxhave, pajisjeve kthyesë, zinxhirë, kavo etj.;

- Të menaxhojë me kujdes mbetjet (vajra, solvente etj.) si dhe mjetet e pastrimit (lecka etj.);
- Të kryejë sigurimin e autorizimeve të nevojshme për procedurat specifike të ndërhyrjes me karakter mekanik dhe elektrik;
- Të hartojë lejen e punës me zjarr;
- Të respektojë rregullat e sjelljes dhe të lëvizjes në vendin e punës;
- Të mirëmbajë veglat dhe pajisjet e punës në respekt të rregullores së sigurimit teknik dhe të higjienës në punë;
- Të sinjalizojë sipas rregullave për çdo anomali në funksionimin jo të mirë të tyre;
- Të bëjë vlerësimin e rezultateve të arritura në bazë të instruksioneve të marra;
- Të respektojë rregullat e sistemit të sigurimit të cilësisë;
- Të zbatojë parimet dhe kriteret e marrëdhënies « klient ↔ furnitor ».

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Në përfundim të kualifikimit profesional në profilin “Mekanikë bujqësore”, niveli II, nxënësi do të përvetësojë kompetencat e përgjithshme të mëposhtme:

- Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet e ndjenjat e tij dhe për të argumentuar opinionet për çështje të ndryshme;
- Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
- Të nxisë potencialin e tij të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
- Të përfshihet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
- Të zbatojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale e rajonale;
- Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij/saj;
- Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
- Të organizojë drejtë procesin e të nxënësve të tij dhe të shfaqë gatishmërinë dhe vullnetin për të nxënë gjatë gjithë jetës;
- Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëjetojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
- Të vlerësojë dhe vetë vlerësojë nisur nga kriteret e drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij/saj;
- Të demonstrojë sjellje dhe qëndrime etike në veprimtaritë shkollore dhe në komunitet;
- Të demonstrojë aftësinë për të pranuar dhe promovuar ndryshimin dhe inovacionin;
- Të demonstrojë aftësinë për të komunikuar dhe negociuar idetë në mënyrë efektive me të tjerët;
- Të demonstrojë aftësinë për të menduar në mënyrë krijuese dhe novatore;
- Të demonstrojë aftësinë për të identifikuar dhe për të zgjidhur në mënyrë krijuese problemet.